



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë Ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Trajtimit të Ujërave të Zeza në Ferizaj.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Provimin e Maturës Shtetërore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/198

Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Amendamentimit Nr. 1. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2020.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Stemën dhe Vulën e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe Organeve Inspektuese si dhe për Dokumentin e Identifikimit të Inspektorëve të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Përmbajtjen e Procesverbalit të Inspektimit.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/198

Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024 – 2028.
2. Buxheti për zbatimin e këtij Programi është brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2024 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Programit, që të zbatojnë këtë Vendim.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim përfundimtar.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2025-2027.
2. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë përcakton kornizën e politikave për përgatitjen e Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve dhe buxhetin vjetor e hartuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
3. Organizatat buxhetore obligohen që gjatë propozimit të shpenzimeve në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të marrin parasysh Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2025-2027.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafit 2. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 4,000,000€ (katër milionë euro), për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Kontigjencat në Ministrinë e Financave", me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me kod 212, në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11312, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues Ndërinstitucional, për përgatitjen e pjesëmarrjes së Republikës së Kosovës, në EXPO 2025/Osaka, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kryesues;
 - 1.2. Ministria e Ekonomisë, anëtar;
 - 1.3. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtar;
 - 1.4. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar; dhe
 - 1.5. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtar.
2. Grupi Punues, i cekur si në pikën 1. të këtij Vendimi ka për detyrë të organizoj dhe koordinoj procesin e përgatitjes dhe pjesëmarrjes së Republikës së Kosovës në EXPO 2025, që mbahet në Osaka të Japonisë.
3. Kryesuesi, mund të propozoj edhe angazhimin e zyrtarëve nga institucionet e tjera, ekspertëve të jashtëm, për të ndihmuar Grupin Punues në aspektin profesional, në kuadër të pjesëmarrjes së Republikës së Kosovës në EXPO 2025.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 255 të Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:


V E N D I M

Për themelimin e Këshillit për Siguri në Trafikun Rrugor

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për themelimin e Këshillit për Siguri në Trafikun Rrugor (në tekstin e mëtejme: KSTRr), në përbërje si vijon:
 - 1.1. Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - kryesues;
 - 1.2. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme - anëtar;
 - 1.3. Ministria e Ministrisë së Drejtësisë - anëtare;
 - 1.4. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë - anëtar;
 - 1.5. Ministria e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - anëtare;
 - 1.6. Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve - anëtar;
 - 1.7. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë - anëtar;
 - 1.8. Kryesuesi i Asociacionit të Komunave - anëtar; dhe
 - 1.9. Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit - anëtar.
2. Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - Departamenti Koordinues i Këshillit për Siguri në Komunikacionin Rrugor do të ofrojë shërbime administrative dhe të Sekretarisë për anëtarët e KSTRr- së.
3. KSTRr do të ketë këto kompetenca:
 - 3.1. Zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe masave në fushën e sigurisë rrugore;
 - 3.2. Ngritjen e vetëdijes publike për çështjet e sigurisë rrugore nëpërmjet organizimit të fushatave të përhershme promovuese;
 - 3.3. Koordinimin e punës së të gjitha institucioneve të cilat janë të përfshira në sigurinë e trafikut rrugor;
 - 3.4. Koordinimin e punës me të gjitha subjektet e tjera për promovimin e sigurinë e trafikut rrugor.
4. KSTRr themelon grupe punuese me propozimin e Ministrisë në fushat përkatëse të përbëra nga ekspertë të ndryshëm, përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ) që mbrojnë interesat e shoqërisë në siguri-në rrugore, për të shqyrtuar dhe analizuar çështjet e veçanta dhe për të dhënë rekomandime për rritjen e sigurisë rrugore.

5. Këshilli mund të emërojë zyrtarë apo persona tjerë përgjegjës për zbatimin e veprimeve, masave dhe politikave në fushën e sigurisë rrugore.
6. Koordinimi i punës së KSTRr-së dhe institucioneve dhe subjekteve tjera do të bëhet nga Sekretaria e KSTRr-së.
7. Kryesuesi i KSTRr-së do të raportoj përmes Qeverisë së paku një (1) herë brenda vitit para Kuvendit të Republikës së Kosovës për sigurinë në trafikun rrugor.
8. KSTRr Inicion plotësimin dhe ndryshimin e politikave, rregulloreve dhe masave në përputhje me rregulloret dhe standardet e Bashkësisë Evropiane (BE) si dhe bën propozime për vendime të rëndësishme për zbatimin e projekteve përkatëse dhe aktivitetëve të tjera me qëllim të rritjes së sigurisë së trafikut rrugor të cilat do të jenë të obligueshme për të gjitha institucionet dhe subjektet të cilave iu drejtohen.
9. KSTRr miraton Programin Nacional për Siguri në Trafikun Rrugor.
10. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, që sipas kërkesës së kryesuesit të KSTRr-së të siguroj mjete financiare për punën e KSTRr-së, angazhimin e ekspertëve të jashtëm dhe grupet punuese.
11. Obligohet Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
12. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr.10/71, i datës 23 tetor 2018.
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/198
Datë: 02.04.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi shtesë për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, Segmenti Banullë-Bresallc, Zona Kadastrale: Zhegovc Komuna Gjilan, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme /Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjisllacionit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/198
Datë: 02.04.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore P. Sh. "Progres" e cila preket nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Qendrës së Paraburgimit dhe Institucionit Korrektues në Prizren" për nevoja të Shërbimit Korrektues të Kosovës/Ministria e Drejtësisë, ZK Dushanovë, Komuna Prizren, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Shërbimi Korrektues i Kosovës/Ministria e Drejtësisë.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Shërbimi Korrektues i Kosovës/Ministria e Drejtësisë.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë me mallra strategjike, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet përditësimi i Listës Shtetërore Strategjike për Mallra me Përdorim të Dyfishtë, duke iu referuar Listës së Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike ose për arsye të drejtave të njeriut, në përputhje me Rregulloren e deleguar të komisionit të BE-së 2023/2616 të datës 15 shtator 2023, duke ndryshuar Rregulloren e BE-se 2021/821 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatim të këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 13 të Udhëzimit administrativ Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor 2024-2030.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Planit Strategjik nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti në Fushën e Aviacionit Civil.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/198
Datë: 02.04.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 14, paragrafit 40.4 të Ligjit Nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi për Performancë të Lartë Sportive "Super Sportistët" i cili ka për qëllim mbështetjen e qëndrueshme të sportistëve të Republikës së Kosovës përgjatë karrierës së tyre aktive, duke u përqëndruar tek sportistët me potencial të lartë për të arritur suksese në arenën ndërkombëtare sportive.
2. Për zhvillimin, planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e këtij programi themelohet Komisioni për Performancë të Lartë Sportive.
3. Për ciklin Olimpik 2024 - 2028, për programin "Super Sportistët" është planifikuar buxhet në vlerë rreth 4,000,000€ (katër milionë euro), buxhet ky i cili sigurohet përmes kodit buxhetor të nën programit Sportet e Gjera me kod 80100, kategoria e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe nuk kërkohet buxhet shtesë për zbatim të tij.
4. Programi "Super Sportistët" synon të identifikojë dhe të përzgjedhë talentët sportivë të Kosovës në sporte të ndryshme dhe të ndihmojë zhvillimin maksimal të talentit të tyre sportiv me qëllim të përfaqësimit dinjitoz të shtetit në arenën ndërkombëtare përmes rezultateve në Lojërat Olimpike, Kampionatet Botërore dhe Evropiane, Lojërat Evropiane, si dhe Lojërat Mesdhetare, duke përfshirë grupmoshat si në konkurrencën e seniorëve, ashtu edhe në atë të të rinjve ku aplikohet.
5. Pjesë e këtij Vendimi është Programi për Performancë të Lartë Sportive "Super Sportistët".
6. Komisioni për Performancë të Lartë Sportive si në pikën 2. të këtij Vendimi ka këtë përbërje:
 - 6.1. Driton Kuka - trajner me rezultate të dëshmuara në arenën ndërkombëtare, kryesues;
 - 6.2. Edmond Azemi - ish-sportist i dalluar, anëtar;
 - 6.3. Arsim Maxhera - gazetar sportiv, anëtar;
 - 6.4. Kushtrim Krasniqi - përfaqësues i Komitetit Olimpik të Kosovës, anëtar;
 - 6.5. Shkëlqim Sadriu - përfaqësues i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar.

7. Anëtarët e Komisionit si në pikën 6 të këtij vendimi kompensohet për punën e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
8. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të bëjë zbatimin e pikës 7. të këtij Vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Granti për Performancë të Lartë Sportive
“SUPER SPORTISTËT”
GPLS-SS

1. Hyrje

Duke konsideruar numrin e talentëve sportivë në Republikën e Kosovës dhe potencialin e tyre për të arritur sukses në arenën ndërkombëtare, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka vendosur të prioritzojë mbështetjen e sportistëve për performancë të lartë sportive, në përputhje me masën strategjike 7.3.1 "Mbështetja e qëndrueshme e sportistëve potencialë për të fituar medalje në arenën ndërkombëtare" të qëllimit strategjik 7.3 të Planit Kombëtar për Zhvillim, "Shoqëri aktive dhe e shëndetshme përmes aktivitetit sportiv".

Kosova ka marrë pjesë në dy edicione të Lojërave Olimpike Verore dhe Dimërore, duke përfshirë Rio 2016, PyeongChang 2018, Tokyo 2020 dhe Beijing 2022. Përveç kësaj, në dy paraqitjet e saj në Lojërat Olimpike Verore, sporti i Kosovës ka arritur të fitojë tre medalje të arta Olimpike në xhudo, një në Rio dhe dy në Tokyo.

Në Rio 2016, Kosova u përfaqësua me tetë (8) sportistë, prej të cilëve dy (2) ishin kualifikuar me norma olimpike në sportin e xhudos, tre (3) ishin ftuar me ftesa të univerzalitetit dhe dy (2) me ftesa të komisionit tre-palësh. Në Tokyo 2020, Kosova kishte një ekip prej 11 sportistësh, ku 6 ishin kualifikuar me norma olimpike në sportin e xhudos dhe në mundje, ndërsa të tjerët ishin ftuar në bazë të kriterëve të univerzalitetit dhe të komisionit tre-palësh.

Në Lojërat Dimërore PyeongChang 2018, Kosova u përfaqësua me një sportist me normën bazë olimpike në sportin e skijimit, ndërsa në Lojërat Dimërore Beijing 2022, Kosova u përfaqësua me dy sportistë me norma bazike në skijim.

Në ekipin pjesëmarrës të Kosovës në Lojërat Olimpike Paris 2024, deri më tani Kosova ka siguruar gjashtë norma olimpike, pesë në xhudo dhe një në boks.

Me qëllim të mbështetjes së sportistëve me potencialë të lartë për të arritur suksese në arenën ndërkombëtare, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nisur programin e grantit për performancë të lartë sportive - "*Super Sportistët*" në mënyrë që talentët e rinj të sportit të Kosovës të kenë mundësinë për arritur suksese përmes mbështetjes së qëndrueshme të përqëndruar në performancë të lartë përgjatë karrierës së tyre sportive.

Me synim të maksimizimit të burimeve mbështetëse të sportistëve, krijimit të kushteve të nevojshme, dhe rritjes së numrit të medaljeve për Republikën e Kosovës në garat sportive ndërkombëtare, granti për performancë të lartë do të shpërndahet strategjikisht në kategorinë e sporteve në të cilat ekziston potenciali real për të fituar normë olimpike dhe për të arritur rezultate kulminante në Lojërat Olimpike, Kampionatet Botërore dhe Evropiane, Lojërat Evropiane, si dhe Lojërat Mesdhetare.

2. Qëllimi dhe Objektivat e GPLS-SS

Programi "Super Sportistët" është grant për performancë të lartë sportive i inicuar nga autoritetet sportive në Kosovë për të mbështetur sportistët me potencial të lartë për të arritur suksese në arenën ndërkombëtare.

Objektivat e përgjithshme të këtij programi janë:

- Zhvillimi i potencialit për rezultate kulmore në sport përmes mbështetjes së talentëve sportivë përgjatë karrierës së tyre sportive;
- Përfaqësimi i lartë i shtetit në garat sportive ndërkombëtare përmes paraqitjeve të suksesshme sportive në Lojërat Olimpike, Kampionatet Botërore dhe Evropiane, Lojërat Evropiane, si dhe Lojërat Mesdhetare, duke përfshirë grupmoshat si në konkurrencën e seniorëve, ashtu edhe në atë të të rinjve ku aplikohet.
- Rritja e ndërgjegjësimit shtetëror për arritjet e sportistëve tanë, duke e bërë sportin burim krenarie kombëtare dhe burim inkurajimi për angazhimin e të rinjve në shoqëri.

Në mënyrë specifike, objektivat e programit përfshijnë:

- Rritjen e numrit të sporteve të cilat përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpike me normë olimpike;
- Rritjen e numrit të sportistëve të cilët arrijnë medalje në Kampionate Evropiane dhe Kampionate Botërore për të rinj dhe senior;
- Rritjen e numrit të sporteve dhe sportistëve të cilët i sjellin Kosovës medalje nga Lojërat Mesdhetare dhe Lojërat Evropiane;
- Rritjen e numrit të sporteve të cilët fitojnë medalje në Lojërat Olimpike Verore dhe Dimërore;

3. "Super Sportistët"

"Super Sportistët" synon të identifikojë dhe të përzgjedhë top-talentët e Kosovës dhe të ndihmojë në zhvillimin e tyre përmes mbështetjes financiare dhe trajnimit të specializuar. Kjo përfshinë sigurimin e resurseve të nevojshme për trajnimin e tyre dhe pjesëmarrjen në stërvitje profesionale, përkujdesin dhe zhvillimin shëndetësor, furnizimin me pajisje profesionale dhe inovative për zhvillim maksimal të potencialit, si dhe mbikëqyrjen e progresit sportiv dhe mirëqenies së sportistit përgjatë karrierës së tyre profesionale.

Rezultatet e synuara të këtij programi janë të orientuara në pjesëmarrjen e suksesshme dhe rritjen e numrit të medaljeve të sportistëve të Kosovës në garat ndërkombëtare prestigjioze duke përfshirë, por duke mos u limituar në:

- Lojërat Olimpike;
- Kampionate Botërore për të rinj dhe senior;

- Kampionate dhe Lojëra Evropiane për të rinj dhe senior;
- Lojërat Mesdhetare

Periudha kohore mbi të cilën janë ndërtuar synimet e programit “Super Sportistët” parasheh periudhën 8 vjeçare, respektivisht vitet 2024 - 2032 të ndara në cikle Olimpike si mëposhtë:

- Lojërat Olimpike 2028;
- Lojërat Mesdhetare, Prishtina 2030;
- Lojërat Olimpike 2032.

“Super Sportistët”, përveç garave kulmore të specifikuara më lartë, përfshinë rezultatet e sportistëve edhe në të gjitha garat e tjera ndërkombëtare që zhvillohen gjatë cikleve Olimpike.

Zbatimi i programit planifikohet të realizohet në 3 cikle, të ndara në 8 sezona sportive. Cikli i parë Olimpik përfshinë sezonën 2024/2025, sezonën 2025/2026, 2026/2027, dhe 2027/2028 deri në organizimin e Lojërave Olimpike, Los Angeles 2028.

Në pjesën e mëposhtme të dokumentit janë të elaboruara synimet, bashkëpunimi dhe partneriteti, buxheti, si dhe pjesë tjera përkatëse të ndërlidhura me zbatimin e programit.

Synime e programit "Super Sportistët"

2024-2032

SYNIMET												
	Para 2024	2024	2024/2025	2025/2026	2026/2027	2027/2028	2028/2029	2029/2030	2030/2031	2031/2032		
Numri i sporteve me normë Olimpike	n/a	2	2	2	2	5	5	6	6	8		
Numri i sportistëve me normë Olimpike	n/a	6	6	6	6	10	10	11	11	15		
Numri i sporteve me medalje Olimpike	1	TBD	TBD	TBD	TBD	2	2	2	2	3		
Numri total i medaljeve Olimpike të Kosovës	3	TBD	TBD	TBD	TBD	6	6	6	6	8		
Numri i sporteve me medalje në Kampionatet Evropiane, Lojërat Evropiane (kur janë të nivelit të Kampionatit Evropian) dhe Kampionatet Botërore;	2	2	2	2	3	3	5	6	6	8		
Numri i sportistëve me medalje në Kampionatet Evropiane, Lojërat Evropiane dhe Kampionatet Botërore;	8	8	9	9	10	10	12	13	14	15		
Numri i sporteve me medalje në Lojërat Mesdhetare	2	2	2	4	4	4	4	10	10	10		
Numri i sportistëve me medalje në Lojërat Mesdhetare	10	10	10	21	21	21	21	45	45	45		
Numri i sporteve me medalje në Kampionate/Lojëra Evropiane, EYOF, Lojëra Olimpike për të Rinj dhe Kampionate Botërore për të rinj;	4	4	4	5	5	6	6	7	7	8		
Numri i sportistëve me medalje në Kampionate/Lojëra Evropiane, EYOF, Lojëra Olimpike për të Rinj dhe Kampionate Botërore për të rinj;	45	45	50	57	65	73	82	92	102	115		

4. Partneriteti dhe Bashkëpunimi

Në kontekst të partneritetit, bashkëpunimi me shtyllën sportive është shumë i rëndësishëm për t'i ofruar qëndrueshmëri zhvillimit të sportistëve dhe zbatimit të këtij programi. Programi i performancës së lartë sportive "Super Sportistët" do të zbatohet përmes krijimit të një strukture organizative gjithëpërfshirëse, e cila do të jetë përgjegjëse për zhvillimin, planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e këtij programi. Struktura organizative do të themelohet dhe emërohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Përbërja

Në kuadër të strukturës përgjegjëse për "Super Sportistët" do të përfshihen përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e sportit në vend, përfaqësues të organizatave sportive, si dhe profesionistë dhe ekspertë të profilizuar në fushën e sportit. Disa akterë të rëndësishëm të partneriteti janë:

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Komiteti Olimpik i Kosovës;
- Federatat e sporteve përkatëse të cilat do të përfshihen në program;
- Klubet sportive ku janë anëtarë sportistët e përzgjedhur të programit;
- Bashkëpunimi me federatat ndërkombëtare të sporteve përkatëse;
- Bashkëpunimi me sportistët dhe prindërit e sportistëve;
- Bashkëpunimi me universitete dhe institute shkencore sportive; dhe
- Të tjera.

Kompetenca e strukturës përgjegjëse

Kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për programin "Super Sportistët" përfshijnë:

- Hartimi dhe zbatimi i planeve të veprimit për zhvillimin dhe përmirësimin e performancës së sportistëve, duke koordinuar veprimtaritë në të gjitha nivelet.
- Monitorimi dhe vlerësimi i përparimit të sportistëve, duke përdorur metoda të ndryshme për të identifikuar sukseset dhe sfidat në realizimin e qëllimeve të programit.
- Hartimi dhe realizimi i procesit për aplikimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e sportistëve të programit "Super Sportistët";
- Zhvillimin e bashkëpunimit të ngushtë me institucionet shtetërore, organizatat sportive, dhe partnerët e tjerë për të koordinuar proceset për zbatimin e programit dhe përpjekjet për të përmirësuar efikasitetin e programit.
- Koordinimi i veprimeve me federatat sportive vendore dhe ndërkombëtare të sporteve përkatëse për të siguruar pjesëmarrjen dhe kontributin e duhur në garat ndërkombëtare.
- Sigurimi i një komunikimi efektiv dhe transparent me sportistët dhe familjet e tyre për të mbështetur dhe motivuar ata në rrugën e tyre drejt suksesit sportiv.

- Identifikimi dhe zhvillimi i partneriteteve me universitetet, institute shkencore sportive, dhe organizata të tjera për të shfrytëzuar njohuritë dhe burimet për përparimin e sportistëve.
- Përpunimi dhe raportimi i të dhënave relevante për performancën e sportistëve dhe aktivitetet e programit për të përmirësuar proceset dhe vendimet në të ardhmen.

5. Format e mbështetjes

Aktivitetet dhe shërbimet që financohen përmes programit "Super Sportistët"

Programi "Super Sportistët" synon të shërbejë si strukturë mbështetëse profesionale dhe financiare përmes së cilës sportistët e sporteve individuale mentorohen, udhëzohen dhe ndihmon financiarisht për zhvillimin e potencialit të tyre për rezultate në arenën ndërkombëtare sportive. Aktivitetet sportive dhe aktivitetet përcjellëse të cilat mbështeten përmes programit janë:

Pjesëmarrjen në kampe stërvitore jashtë Kosovës: Për të gjithë sportistët e "SS", programi do të ndihmojë në mbulimin apo zvogëlimin e kostove të udhëtimit për ofruar mundësitë për sportistët që jënë pjesë e kampeve stërvitore profesionale. Shpenzimet që mbulohen përmes këtij aktiviteti janë: transporti, akomodimi, ushqimi, pagesa e kampit, etj.

Pjesëmarrja në gara sportive jashtë Kosovës: Për sportistët e përzgjedhur të "SS" do të mbulohen shpenzimet e pjesëmarrjes në gara sportive vetëm atëherë kur federata shtetërore përkatëse nuk merr pjesë në atë garë.

Pagesa për organizim dhe pjesëmarrje në kampe stërvitore brenda Kosovës: "SS" do të mundësojë mbulimin e shpenzimeve të sportistëve të cilët për përgatitje stërvitore do të duhet të lëvizin nga një qytet/fshat në tjetrin përbrenda territorit të Republikës së Kosovës. Shpenzimet që mbulohen përmes këtij aktiviteti janë: transporti, akomodimi, ushqimi, etj.

Pagesa e trajnerit ndërkombëtar: SS do të ndihmojnë në financimin ose zvogëlimin e çdo pagese për trajner vendor apo ndërkombëtar që nevojiten për të mbështetur zhvillimin e sportistëve. Ky financim aplikohet vetëm për trajnerët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ekspertët dhe të cilët kanë arritur rezultate të dëshmuara në arenën ndërkombëtare.

Mbulimi i kostos për sigurimin e pajisjeve sportive: Për të gjithë sportistët e SS, programi do të ndihmojë në mbulimin e shpenzimeve për blerjen e pajisjeve sportive profesionale dhe inovative të nevojshme për trajnimin e sportistëve dhe për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare.

Mbulimi i kostove të hapësirave sportive jashtë vendit dhe brenda vendit: SS do të ofrojë mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve për shfrytëzimin e hapësirave sportive brenda dhe jashtë vendit për sportet në të cilat nuk ekziston infrastruktura optimale për zhvillimin e talentit sportiv. Mbulimi i shpenzimeve bëhet vetëm në rastet kur hapësirat sportive janë nën pronësinë e sektorit privat. Në

rastet kur hapësirat janë pronë publike, atëherë programi do të mundësojë qasje të lehtë për sportistët e programit.

Kontrollat mjekësore dhe rehabilituese për sportistët: Ky program do të ndihmojë mbulimin dhe zvogëlimin e kostove për trajtimin mjekësor të sportistëve duke mbështetur zhvillimin e trajnimit dhe rikuperimit të sportistit.

Testimet profesionale sportive: Programi SS përfshinë edhe mbulimin e kostos për realizimin e testeve të specializuara dhe evaluimeve të sportistëve për të përcaktuar nivelin e performancës dhe për të zhvilluar strategji të personalizuara për përmirësimin e aftësive sportive.

Ushqimi dhe shtesat sportive: Kjo përfshinë mbulimin e shpenzimeve për të siguruar ushqim të përshtatshëm dhe shtesat e nevojshme për të mbështetur performancën e përgjithshme të sportistëve.

Incentivë familjare: Në rastet kur sportisti/sportistja e moshës 18 vjeçare e më shumë është përfitues/e nga programi SS me statusin familjar me të hyra mesatare ekonomik, në kuadër të shpenzimeve që mbulohen nga SS përfshihet edhe mbështetja direkte në formë të incentives familjare, me qëllim që sportisti/sportistja të lirohet nga obligimet financiare familjare. Vlera e kësaj mbështetje nuk mund të tejkalojë pagën mesatare në nivel vendi. Për të përfituar të drejtën e shfrytëzimit të kësaj incentive, aplikuesi duhet të dëshmojë të hyrat familjare nga Trustit.

6. Buxheti i Programit "SS"

Për ciklin Olimpik 2024 - 2028 programi "Super Sportistët" ka buxhet në vlerë prej 4,000,000.00 euro. Ky buxhet sigurohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes kodit buxhetor 80100, përkatësisht nën programit Sportet e Gjera, në kategorinë e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve. Nëpërmjet këtij programi synohet që në bashkëpunim me organizatat sportive të sigurohen fonde edhe përmes projekteve dhe bashkëpunimit me partnerë të tjerë vendor dhe ndërkombëtar.